

AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BULQIZE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

30/11/2022

Drejtuar: "BOE DAAM Nipt-i L72205042F shpk dhe NET-GROUP Nipt-i L72023002P: Adrese Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Zogu I-rë, Njesia Administrative nr.9, pasuria nr.5/319-N39, ZK.8350, Pallati Alko Impex nr.1

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e thjeshtuar me mjete elektronike.

Numri i procedurës REF- 48843-11-07-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Objekti I Prokurimit: **"Mbikqyrje punimesh te objektit Ndertim Sistem Kanalizimesh dhe Impjant Trajtimi te Ujrave te Ndotura ne Qytetin Bulqize Lagja e Re".**

Kohezgjatja e Konrates 120 dite.

Publikimet e mëparshme NUK KA

Buletini i Njoftimeve Publike numer 156 date 14/11/2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1-SHPK "BN PROJECT " Nipt-i L21305035S me vlere 1 377 772 (Nje milion e treqind e shtatedhjete E e shtate mije e shtateqind e shtatedhjete e dy)leke pa tvsh.

2-BOE DAAM Nipt-i L72205042F shpk dhe NET-GROUP Nipt-i L72023002P me vlere 2 734 603,48(Dymilion e shtateqind e tridhjete e kater mije e gjashteqind e tre presje dyzet e tete)leke pa tvsh.

3-G B Civil Engineering shpk me Nipt-i L51825011V me vlere 2 692 231,49(Dy milion e gjashteqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e tridhjete e nje presje dyzet e nente)leke pa tvsh.

4-MAGNA CHARTA shpk me Nipt-i L92318021H me vlere 2692231,48(dy milion e gjashteqind e nentedhjete e dymije e dyqind e tridhjete e nje presje dyzet e tete)leke pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1-SHPK “BN PROJECT ” Nipt-i L21305035S me vlere 1 377 772 (Nje milion e treqind e shtatedhete E e shtate mije e shtateqind e shtatedhete e dy)leke pa tvsh.

Arsyet e skualifikimit :

Nuk ka plotësuar kriteret e vecanta per kualifikim :

Mungon dokumentacioni per te provuar kapacitetet ekonomik dhe financiar sipas pikes 2.2.1

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se parashikuar te kontrates (vlera e fondit limit)

Mungon dokumentacioni per te provuar kapacitetet ekonomik dhe financiar sipas pikes 2.2.2

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Mungon dokumentacioni per te provuar kapacitetin tekni sipas pikes 2.3.1

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % te vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme* të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) *për përvojën e mëparshme* të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Mungon dokumentacioni per te provuar kapacitetet sipas pikes 2.3.2

- 1.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikqyrjetë** lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise sipas percaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”, me kategoritë si më poshtë

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1	Punime gjurmimi në tokë
2	NP- 2	Ndërtime civile dhe industriale
3	NP-4	Rruge Autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvaj,metro,pista aeroportuale
4	NP-5	Punime Nentokesore,ura, e vepra arti
5	NP-7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
6	NP-12	Punime te Inxhinierise se Mjedisit
7	NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve
8	NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to
9	NS-6	Sinjalistika rrugore jo ndricuese
10	NS-18	Punime topogjeodezike

Mungon dokumentacioni per te provuar kapacitetet sipas pikes 2.3.3

- 3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

1-Inxhinier Ndertimi 1(nje).

2-Inxhinier Hidroteknik 1(nje).

3-Inxhinier Mjedisi 1(nje).

4-Inxhinier Mekanik 1(nje).

5-Inxhinier Elektrik 1(nje).

6-Inxhinier Gjeodet 1(nje).

7-Inxhinier Gjeolog 1(nje).

Drejtuksi Teknik të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

***** Në këtë rasti stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

Shënim:Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për secilin pjestar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë:

Kontrate pune e vlefshme

Diplome

Libreze pune

CV

Shënim:Operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërcituar.

Mungon dokumentacioni për të provuar kapacitetet sipas pikës 2.3.4

3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **10 person**adhe të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit

Shënim:Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit

Mungon dokumentacioni për të provuar kapacitetet sipas pikës 2.4.1

2.4.1Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 **Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**

ISO 45001: 2018& **Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Mungon dokumentacioni për të provuar kapacitetet sipas pikes 2.4.2

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjes të specializuar /kualifikuar si me poshte:

-1(nje)punonjes i paisur dhe certifikuar **“Ekspert për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave “ e cila te jete e leshuar nga Kryqi i kuq Shqiptar ose nga shoqeri te akredituara.**

-1(nje) punonjes qe disponon certifikaten si **“Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”** ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18/02/2010 **“Per sigurine dhe shendetin ne pune “dhe V.K.M.nr 312 date 05/05/2010 “Per miratimin e rregullores “Per sigurine ne kantier”.**

Per permbushjen e ketij kriteri operatori duhet te paraqese diplome/certifikatat e cituara me siper.

Në rastet e bashkimit të operatorëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

SHENIM:Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë domosdoshmerisht në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM. Kjo kerkese bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

- Të gjitha ofertat që do të jene me vlere me të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, **do të refuzohen.**

2-G B Civil Engineering shpk me Nipt-i L51825011V me vlere 2 692 231,49(Dy milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e nje presje dyzet e nente)leke pa tvsh.

Arsyeja e skualifikimit.

Operatori ekonomik “G B Civil Engineering ” shpk NUIS: L 51825011 V

Vlera e ofertës ekonomike e paraqitur nga Operatori ekonomik ““G B Civil Engineering ” shpk, është më e ulët se vlera minimale e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, për këtë procedure,

çka bie ne kundershtim me detyrimet e percaktuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", (i ndryshuar) si dhe Njoftimit Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" si dhe njoftimit Nr.13565.Prot, datë 06.11.2017, të Agjensisë së Prokurimit Publik, ku kerkohet detyrimi per zbatimin e akteve ligjore, nenligjore dhe VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Shërbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim". Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permbush kerkesat e percaktuara ne Shtojcen 8, Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta te Kualifikimit.

3-MAGNA CHARTA shpk me Nipt-i L92318021H me vlere 2692231,48(dy milion e gjashteqind e nentehjete e dymije e dyqind e tridhjte e nje presje dyzet e tete)leke pa tvsh.

Arsyeja e skualifikimit.

Operatori ekonomik "MAGNA CHARTA" shpk NUIS: L92318021H

Vlera e ofertës ekonomike e paraqitur nga Operatori ekonomik "MAGNA CHARTA" shpk, është më e ulët se vlera minimale e përllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, për këtë procedure, çka bie ne kundershtim me detyrimet e percaktuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", (i ndryshuar) si dhe Njoftimit Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" si dhe njoftimit Nr.13565.Prot, datë 06.11.2017, të Agjensisë së Prokurimit Publik, ku kerkohet detyrimi per zbatimin e akteve ligjore, nenligjore dhe VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim". Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permbush kerkesat e percaktuara ne Shtojcen 8, Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta te Kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE DAAM Nipt-i L72205042F shpk dhe NET-GROUP Nipt-i L72023002P Adrese Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Zogu I-rë, Njesia Administrative nr.9, pasuria nr.5/319-N39, ZK.8350, Pallati Alko Impex nr.1

me vlere 2 734 603,48(Dymilion e shtateqind e tridhjte e kater mije e gjashteqind e tre presje dyzet e tete)leke pa tvsh.. totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BULQIZE